



Raporti i vitit 2021

Gusht 01- 31.08.2021

1. Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave

Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave gjatë muajit gusht 2021, ka kryer këto aktivitete: Kërkesat për hartimin e detyrave projektuese dhe identifikimin e nevojave, shqyrtimin e kërkesave të banorëve të bashkësive lokale dhe inkorporimin e tyre në planet e Komunës, njoftimi me kohë i kompanive publike dhe subjekteve relevante me qëllim të koordinimit të punëve, incizimit të gjendjes ekzistuese të infrastrukturës në qytetin e Prishtinës, si dhe kompletimit të dokumentacionit teknik për procedimin e tyre në organet kompetente, mbikëqyrjen e realizimit të projekteve konform marrëveshjes etj.

1.1. Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë muajit gusht 2021, drejtoria ka proceduar 174 kërkesa të ndryshme të bashkësive lokale dhe banorëve: për ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe kanalizimeve, kërkesa për rregullimin e rrugëve dhe kanalizimeve, kërkesa nga kompanitë publike-leje për gropim dhe intervenime për sanimin e defekteve të ndryshme, kërkesa nga kompanitë për formime të komisioneve për kontrollimin e punëve, kërkesa të natyrave të ndryshme rreth definimit të zgjidhjes në terren etj. Nga numri i përgjithshëm prej 174 kërkesave të pranuar, 132 kërkesa janë të përfunduara.

1.2. Dërgimi i kërkesave për hartimin e detyrave projektuese dhe identifikimin e nevojave

Duke marrë për bazë Ligjin mbi planifikimin hapësinorë, Ligjin mbi ndërtimin e objekteve investive, si dhe Ligjin për projektim, e në veçanti planet rregulluese, janë dërguar kërkesat për hartimin e detyrave projektuese në zonat urbane dhe rurale.



1.3. Raportimi i menaxherëve të projekteve infrastrukturore


| | |
|-------------------------|--|
| Drejtoria | Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave |
| Sektori | Menaxhimi i kontratave (Ndërtimi i ulët) |
| Drejtori | Gëzim Mehmeti |
| Raportoi | Dukagjin Buqaj, idn. - U.D.i shefit të sektorit |
| Kontrolloi – Përpunoi | Muhamed Emra, idn. - zyrtar i lartë për ndërtim urban |
| Periudha raportuese | 01-31.08.2020 |
| Menaxhëret e projekteve | Muhamed Emra Irfete Zejneli Syzana Pllana Qazim Bajrami Dugagjin Buqaj Ibrahim Gervalla Zyhrije Pllana Halil Fejziu |
| Organi mbikqyrës | Azem Buzuku Aferdita Sopi Behxhet Gashi Ramadan Nebiu Hazir Krasniqi Amire Krasniqi Bujar Rama |

| PRISHTINA | | RAPORTI MBIKËQYRËS | | | | | SHIFRA 01 |
|--|--|--|-------------------|--------------------|-------------------|------------------|-------------------|
| Projekti : | Ndërtimi i Qendrës kulturore për të rinj, Bibliotekës në lagjen “Kodra e Trimave” | Vlera e projektit: 424,257.61 € | | | | | |
| Investuesi : | Komuna e Prishtinës | Plani dinamik 150 ditë kalendarike | | | | | |
| Operatori : | Grup operatorësh “Con Des” SHPK, “Euroconstrution” SHPK | Nr.616-19-208-5-1-1 Dt. 14.09.2020 | | | | | |
| Menaxheri i projektit : | Muhamed Emra, idn. | Projekti i vitit: 2020 | | | | | |
| Organi mbikëqyrës : | Arbër Sadiku, idh., Besian Sinani, idn., Halil Demolli, idm., Nazmi Bajrami, ide., Armend Avdiu, idh. hidro, Avdirrahman Zuka, idm.,; Hazir Krasniqi, tek.gjeodet. | | | | | | |
| Kontrollimi - Përshkrimi i punimeve sipas pozicioneve të realizuara | | | | | | | |
| Vëllimi fizik | Punët e realizuara | <ul style="list-style-type: none"> - Pastrimi i terrenit; - Rrethimi i punishtes, sigurimi i punishtes; - Vendosja e tabelës informuese; - Incizimi, piketimi digjital i objektit; - Gërmimi i terrenit deri në nivelin e themelit të pllakës; - Mbushja e gropës ndërtimore me material guror; - Shtresimi i pllakës rrafshuese estrih çimento t=5.0cm; - Furnizimi i shtresës izoluese, hidroizolimi; - Shtresimi i pllakës rrafshuese estrih çimento t=5.0cm.; - Armirimi i pllakës betonarme t=60.0 cm (Zona e poshtme); - Armirimi i pllakës betonarme t=60.0 cm (Zona e sipërme); - Betonimi i kontrapllakës t=60.0cm. | | | | | |
| | Punët në realizim | <ul style="list-style-type: none"> - Kallepimi i mureve betonarme; - Kallepimi i shtyllave betonarme. | | | | | |
| Vëllimi financiar | Situacionet (Pagesat e proceduara) | Situacioni (I) | Situacioni (II) | Situacioni (III) | Situacioni (IV) | Situacioni (V) | Situacioni (VI) |
| | | 50.000.0€ | | | | | |
| Vonesat Shkalla e cilësisë | | -- | | | Mesatar | | |
| Rekomandime, masat për t’u ndërmarrë | | Ju njoftojmë se projekti kryesor nuk përmban sigurimin e gropës ndertimore. Në bazë të projektit, distanca në mes të vijës ndërtimore me objektet individuale ekzistuese për rreth janë shumë afër, duke e pasur parasysh që nuk është bërë sigurimi i gropës ndërtimore nga byroja projektuese. Për shkak të sigurisë së objekteve jemi detyrua që të zhvendoset objekti, në mënyrë që të mos rrezikohen objektet përreth. | | | | | |
| Vlerësimi i progresit në projekt | | Punimet janë duke u zhvilluar sipas planit dinamik të paraparë, mirëpo kemi ngecje në fazën e gërmimit të objektit për shkak të dislokimit të bërë, në mënyrë që të mos rrezikohen objektet individuale ekzistuese përreth. | | | | | |























| PRISHTINA | | RAPORTI MBIKËQYRËS | | | | | SHIFRA 02 | |
|--|---|--|-------------------|--------------------|-------------------|------------------|---------------------|--|
| Projekti : | Ndërtimi i rrugës “Haxhi Bejta” në Grashticë | Vlera e projektit: 67,537.38 € | | | | | | |
| Investuesi : | Komuna e Prishtinës | Plani dinamik 90 ditë kalendarike | | | | | | |
| Operatori : | SHPK ”Beni Construction“ | Nr. 616-19-208-5-1-1 Dt. 29.04.2021 | | | | | | |
| Menaxheri i projektit : | Muhamed Emra, idn. | Projekti i vitit: 2021 | | | | | | |
| Organi mbikëqyrës : | Jeton Zherka, ida. Zyhrije Pllana, ida. | | | | | | | |
| Kontrollimi - Përshkrimi i punimeve sipas pozicioneve të realizuara | | | | | | | | |
| Vëllimi fizik | Punët e realizuara | - Incizimi, piketimi digjital i objektit; - Gërmimi i gjerë i trupit të rrugës. | | | | | | |
| | Punët në realizim | | | | | | | |
| Vëllimi financiar | Situacionet (Pagesat e proceduara) | Situacioni (I) | Situacioni (II) | Situacioni (III) | Situacioni (IV) | Situacioni (V) | Situacioni (VI) | |
| | | | | | | | | |
| Vonesat | Shkalla e cilësisë | -- | | | Dobet | | | |
| Rekomandime, masat për t'u ndërmarrë | Më 23.08.2021, përmes shkresës zyrtare kemi kërkuar nga zyrja e prokurimit, si autoritet kontraktues, që të shqyrtojë mundësinë e ndërprerjes, respektivisht shkëputjes së kontratës, për arsye të mosefikasitetit të treguar të operatorit ekonomik gjate ekzekutimit të punimeve. | | | | | | | |
| Vlerësimi i progresit në projekt | Është kërkuar nga operatori ekonomik përmes shkresës zyrtare, që të rritë kapacitetin dinamik të punimeve, mirëpo deri më tani nuk kemi pasur përmirësim apo ngritje të kapacitetit dinamik të punimeve, me ç'rast kemi kërkuar nga Zyra e prokurimit shqyrtimin e mundësisë së shkëputjes së kontratës në fjalë. | | | | | | | |






| PRISHTINA | | RAPORTI MBIKËQYRËS | | | | | SHIFRA 03 |
|--|---|--|-------------------|--------------------|-------------------|---|---------------------|
| Projekti : | Ndërtimi i rrugëve “Azem Bejta” dhe “Shkodra” | | | | | Vlera e projektit: 42,224.40 € | |
| Investuesi : | Komuna e Prishtinës | | | | | Plani dinamik 60 ditë kalendarike | |
| Operatori : | ”Seticommerc“ SHPK dhe “Burimi” SHPK | | | | | Nr. 616 20 040 511 Dt. 12.04.2021 | |
| Menaxheri i projektit : | Muhamed Emra idn ; | | | | | Projekti i vitit: 2021 | |
| Organi mbikëqyrës : | Sevdije Drenovci, idk, Hazir Krasniqi, teknik i gjeodezisë | | | | | | |
| Kontrollimi - Përshkrimi i punimeve sipas pozicioneve të realizuara | | | | | | | |
| Vëllimi fizik | Punët e realizuara | <ul style="list-style-type: none"> - Incizimi, piketimi digjital i objektit; - Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale; - Gërmimi i gjerë i trupit të rrugës; - Furnizimi dhe shtrirja e tamponit 0-63mm; - Furnizimi dhe shtrirja e tamponit 0-31mm; - Vendosja e skajoreve të betonit 20/24cm; - Vendosja e pllakve të betonit. | | | | | |
| | Punët në realizim | <ul style="list-style-type: none"> - Vendosja e skajoreve të betonit 20/24cm, rruga “Aqif Blyta”; - Vendosja e pllakve të betonit, rruga “Aqif Blyta”; - Gërmimi i gjerë i trupit të rrugës “Azem Bejta” (demontimi i kubzeve). | | | | | |
| Vëllimi financiar | Situacionet (Pagesat e proceduara) | Situacioni (I) | Situacioni (II) | Situacioni (III) | Situacioni (IV) | Situacioni (V) | Situacioni (VI) |
| | | 20.000.0€ | | | | | |
| Vonesat Shkalla e cilësisë | -- | | | Mesatar | | | |
| Rekomandime masat për tu ndërmarë | <p>Vlen të theksohet, te rruga “Azem Bejta”, me rastin e fillimit te ekzekutimit të punimeve, respektivisht pas demontimit të kubzave të betonit janë paraqitur kablot e energjisë elektrike ne nivel të ceket të trupit të rrugës, rishtazi te montuar nga korporata e KEDS-it, në kuadër të projektit të kogjenerimit të rrjetit. Përmes shkresës zyrtare, kemi kërkuar që kablot nëntokësore në nivlein të bëhet fondimi, si dhe sigurimi i kabllove nëntokesore min H=0.50m. Duke pasur parasysh nivelin e cekët të fundimit, është e nevojshme dhe e dosomdoshme që kablot e instaluar rishtazi të mbrohen me një shtresë të betonit, në mënyrë që gjatë shtresimit të rrugës me asfalt, mos të kemi dëmtime të instalimeve nëntokesore.</p> | | | | | | |
| Vlerësimi i progresit në projekt | <p>Punimet janë duke u zhvilluar sipas planit dinamik kalendarik, mirëpo kemi ngecje për shkak të instalimeve nëntokesore, respektivisht kabllo e rrjetit elektrik të ekzekutuar nga kompania e KEDS-it, ku presim intervenimin e fundit, në mënyrë që ne të mund vazhdojmë punimet sipas paramasës, gjegjesisht kontratës.</p> | | | | | | |


















|  RAPORTI MBIKËQYRËS | | SHIFRA 04 Gusht-2021 | | | |
|---|--|--|---------------------|-------------------|-------------------|
| Projekti : | “Ndërtimi i parqeve rekreativo-sportive në kryeqytet” – “Dodona” | Vlera e projektit: 336,436.16 € | | | |
| Investuesi : | Komuna e Prishtinës | Plani Dinamik : 120 Ditë | | | |
| Operatori : | “Rexha” SHPK | Nr.616 20 074 521 dt.30.09.2020 | | | |
| Menaxheri i projektit : | Bujar Rama, idgj. | Projekt i vitit : 2020 | | | |
| Organi mbikëqyrës : | Idn. Besim Qelaj, Ida. Burbuqe Agushi, tek.nd. Sadik Hajdini | | | | |
| Kontrollimi - Përshkrimi i punimeve sipas pozicioneve të realizuara | | | | | |
| Vëllimi fizik | Punët e realizuara | <ul style="list-style-type: none"> ● Punet ndertimore zejtare – Ndërtimi i nyjave sanitare; ● Punimet në fushat e basketbollit; ● Punet në fushën e volejbollit; ● Punimet në fushën e futbollit, si dhe nivelizimi i saj me një shtresë betoni; ● Punimet në fushen e pingpongut; ● Punimi i shtegut të vrapimit, betonimi i shtegut të vrapimit; ● Punimet në këndin e fitnesit; ● Punimi i pjerrinës me beton afer fushes së futbollit; ● Përcaktimi i lokacioniot për vendosjen e pajisjeve të fitnesit, ulëseve dhe shportave; ● Punimet në riparimin, pastrimin dhe lyerjen e rrethojës ekzistuese të parkut: <ul style="list-style-type: none"> • Punimet e dheut dhe mbushjes, • Punimet e betonit, • Punimet e armimit, • Punët e muratimit. | | | |
| | Punët në realizim | ● Vazhdimi punimeve për finalizimin e të gjitha objekteve që i cekëm më lart. | | | |
| Vëllimi financiar | Situacionet (Pagesat e proceduara) | Situacioni 1 | Situacioni 2 | Situacioni | Situacioni |
| | | <p>Nuk është bërë pagesa deri më tani, për shkak se sipas kontratës vlera e situacionit për pagësë 100,000.00 €.</p> <p>Tani jemi në fazën e matjes dhe kalkulimit për një situacion për pagësë në vleren e paraparë. Jemi në fazën e kontrollimit të situacionit të dytë.</p> | | | |
| Vonesat Shkalla e cilësisë | | <p>Për shkak të problemeve të mëdha që kemi pasur ne projektin kryesor, ku komplet gjeometria e objekteve nuk ka qenë e përcaktuar, zgjidhjet dhe pozicionimet e objekteve jemi duke i bërë ne si staf menaxhues i kontratës, andaj dhe kemi pasur vonesa derisa janë përgatitur të dhënat – shënimet për vazhdimin e punimeve për të gjitha objektet që duhet të punohen sipas kontratës, për të gjitha këto është njoftuar projektuesi, nga i cili kemi kërkuar që të përmirësohen mangësitë në projekt.</p> <p>Gjithashtu, jemi në pritje edhe të miratimit të kërkesës për disa pozicione të paparapara nga Drejtoria e Prokurimit, të cilat kanë qenë të domosdoshme për realizimin e projektit.</p> | | | |
| Rekomandime masat për tu ndërmarë | | <ul style="list-style-type: none"> ☞ Punëkryerësit ju ka rekomanduar që me punime t'i përfillë kushtet e punës sipas udhëzimeve në fuqi, të dhënura nga Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera mbi masat e mbrojtjes nga pandemia - COVID 19. | | | |
| Vlerësimi i progresit në projekt | | Për shkak të pandemisë, deri më tani punimet nuk janë zhvilluar me kapacitet të mjaftueshëm. | | | |





| PRISHTINA | | RAPORTI MBIKËQYRËS | | | | | SHIFRA 05 | |
|--|--|--|------------------|-------------------|--------------------|--------------------------------------|--------------------|--|
| Projekti : | "Ndërtimi i kanalizimit fekal, atmosferik, ujësjellësit, si dhe rikonstruktimi i rrugës dhe trotuareve në lagjen "Sofalia" për rrugët "Shpetim Robaj" dhe "Sabit Mushica" | | | | | Vlera e projektit: 933,447.35€ | | |
| Investuesi : | Komuna e Prishtinës | | | | | Plani dinamik : 120 ditë | | |
| Operatori : | "Gashi Ing" SHPK, Suharekë | | | | | Nr. 616-18-415 511 616 18 12-511. | | |
| Menaxheri i projektit : | Syzana Pllana | | | | | Projekti i vitit 2019 | | |
| Organi mbikëqyrës : | Aferdita Sopi, Behxhet Gashi | | | | | | | |
| Kontrollimi - Përshkrimi i punimeve sipas pozicioneve të realizuara | | | | | | | | |
| Vëllimi fizik | Punët e realizuara | Është bërë ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik, ujësjellësit dhe riasfaltimi i rrugës "Shpetim Robaj", mirëpo për shkak të problemeve pronësore nuk ka arritur të realizohet kontrata për rrugën "Sabit Mushica", e cila pas zotimeve nga zyra e kryetarit, për zgjidhje të problemeve kemi vazhduar me realizimin e projektit në rrugën "Sabit Mushica". Vedosja e shtresës së parë të bituagregatit, si dhe shtrimi i trotuareve me kubze në pjesët ku është lejuar rr. "Sabit Mushica". | | | | | | |
| | Punët në realizim | Ngritja e pusetave në rr. "Sabit Mushica". | | | | | | |
| Vëllimi financiar | Situacionet (Pagesat e proceduara) | Situacioni (I-IX) | Situacioni (X) | Situacioni (XI) | Situacioni (XII) | Situacioni (XIII) | Situacioni (XIV) | |
| | | 605,814.39€ | 50,000.00€ | 50,000.00€ | 50,000.00€ | 83,371.00€, | | |
| Vonesat | Për shkak të problemeve pronësore, kemi vonesa në realizim të kontratës- | | | Mesatar | | | | |
| Shkalla e cilësisë | | | | | | | | |
| Rekomandime, masat për t'u ndërmarrë | Drejtoria e Pronës të bëjë zgjidhje me pronarin e parcelës nëpër të cilën kalon rruga "Sabit Mushica". | | | | | | | |
| Vlerësimi i progresit në projekt | Punët janë duke vazhduar në rrugën "Sabit Mushica", përkundër që nuk është arritur marrëveshje me pronarin e parcelës që atakohet në këtë projekt. Është shtruar shtresa e parë e asfaltbetonit t=8cm, pritet së shpejti të shtrohet edhe shtresa finale pas ngritjes së pusetave. | | | | | | | |

*Foto gjatë ekzekutimit të punimeve



|  RAPORTI MBIKËQYRËS | | SHIFRA 06 | | | | | |
|---|--|---|-------------------------------------|-------------------------|-------------------------|--------------------------|-------------------------|
| Projekti : | Ndërtimi i rrugëve në pjesën urbane me infrastrukturë përcjellëse (kanalizimi fekal dhe atmosferik), rr. “Xhevat Begolli”. | Vlera e projektit: 59,085.24€ | | | | | |
| Investuesi : | Komuna e Prishtinës | Plani dinamik: 90 ditë kalend. | | | | | |
| Operatori : | OE “CO-ING” NNSH, Prishtinë | Nr. 616-20-1374 511 dt. 11.05.2021. | | | | | |
| Menaxheri i projektit : | Syzana Pllana | Projekti i vitit 2021 | | | | | |
| Organi mbikëqyrës : | Muhamed Emra, Azem Buzuku | | | | | | |
| Kontrollimi - Përshkrimi i punimeve sipas pozicioneve të realizuara | | | | | | | |
| Vëllimi fizik | Punët e realizuara | Është bërë vendosja e kanalizimit fekal dhe atmosferik në rrugën “Xhevat Begolli” | | | | | |
| | Punët në realizim | Nuk ka | | | | | |
| Vëllimi financiar | Situacionet (Pagesat e proceduara) | Situacioni (I) | Situacioni (II) përfundimtar | Situacioni (III) | Situacioni (XII) | Situacioni (XIII) | Situacioni (XIV) |
| | | 30.000€ | 28,992.61€ | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | | | |
| Vonesat Shkalla e cilësisë | Nuk kemi vonesa | | | Mesatar | | | |
| Rekomandime masat për tu ndërmarrë | | | | | | | |
| Vlerësimi i progresit në projekt | Punët janë zhvilluar në dinamikë të përshejtuar dhe kontrata është realizuar pa pengesa. | | | | | | |

*Foto gjatë ekzekutimit të punimeve



| RAPORTI MBIKËQYRËS | | SHIFRA 07 | | | | | |
|---|--|--|---------------------|---------------------|--|--|--|
| Projekti : | Ndërtimi i rrugës kryesore dhe rrugicave në Bërnicë të Poshtme | Vlera e projektit: 151.202.58€ | | | | | |
| Investuesi : | Komuna e Prishtinës | Plani dinamik : 90 ditë | | | | | |
| Operatori : | NTP "Bashkimi" | Nr. identifikues: 616 20 154 521 | | | | | |
| Menaxheri i projektit : | Ibrahim Gërvalla | Projekti i vitit 2021 | | | | | |
| Organi mbikëqyrës : | Afërdita Sopi, Sevdije Drenovci | | | | | | |
| Punimet e parapara dhe të realizuara me kontratë | | | | | | | |
| Vëllimi fizik | Punët e parapara | - Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve, duke përfshirë këtu lëshesat dhe sinjalizimin | | | | | |
| | Punët në realizim e sipër | -Punimet janë në fazën përmbyllëse | | | | | |
| Vëllimi financiar | Situacionet (Pagesat e proceduara) | Situacioni 1 | Situacioni 2 | Situacioni 3 | | | |
| | | 50 000.00 | 50 000.00 | | | | |



| RAPORTI MBIKËQYRËS | | SHIFRA 08 | | | | |
|---|--|--|---------------------|---------------------|--|--|
| Projekti : | Asfaltimi i rrugëve “Shkëlzen Haradinaj” dhe “Besim Ndreca” (Rilindja) | Vlera e projektit: 117.535.15€ | | | | |
| Investuesi : | Komuna e Prishtinës | Plani dinamik : 60 ditë | | | | |
| Operatori : | SHPK “Rahovica Commerce” | Nr. identifikues: 616 20 8609 511 | | | | |
| Menaxheri i projektit : | Ibrahim Gërvalla | Projekti i vitit 2021 | | | | |
| Organi mbikqyrës : | Behgjet Gashi, Sevdije Drenovci | | | | | |
| Punimet e parapara dhe të realizuara me kontratë | | | | | | |
| Vëllimi fizik | Punët e parapara | - Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve, duke përfshirë këtu sinjalizimin. | | | | |
| | Punët në realizim e sipër | -Punimet janë në fazën përmbyllëse. | | | | |
| Vëllimi financiar | Situacionet (Pagesat e proceduara) | Situacioni 1 | Situacioni 2 | Situacioni 3 | | |
| | | 51 554.79 | | | | |



| RAPORTI MBIKËQYRËS | | SHIFRA 09 | | | | | |
|---|--|---|---------------------|---------------------|--|--|--|
| Projekti : | Ndërtimi i rrugës “Bajram Kelmendi” | Vlera e projektit: 179.999.81€ | | | | | |
| Investuesi : | Komuna e Prishtinës | Plani dinamik : 60 ditë | | | | | |
| Operatori : | SHPK “Kema Company” | Nr.identifikues: 616 20 133 521 | | | | | |
| Menaxheri i projektit : | Ibrahim Gërvalla | Projekti i vitit 2021 | | | | | |
| Organi mbikëqyrës : | Hazir Krasniqi, Sevdije Drenoci | | | | | | |
| Punimet e parapara dhe të realizuara me kontratë | | | | | | | |
| Vëllimi fizik | Punët e parapara | -Rregullimi i rrugëve duke përfshirë këtu sinjalizimin | | | | | |
| | Punët në realizim e sipër | -Rregullimi i rrugës “Mustafa Kruja” dhe “Shaip Kamberi” | | | | | |
| Vëllimi financiar | Situacionet (Pagesat e proceduara) | Situacioni 1 | Situacioni 2 | Situacioni 3 | | | |
| | | 50.000.00 | | | | | |



| RAPORTI MBIKQYRËS | | SHIFRA 10 | | | | |
|---|--|---|---------------------|---------------------|--|--|
| Projekti : | Ndertimi i rrugës me kubza në lagjet “Arberia” dhe “Emshiri” | Vlera e projektit: 78.503.54€ | | | | |
| Investuesi : | Komuna e Prishtinës | Plani dinamik : 60 ditë | | | | |
| Operatori : | SHPK “Papenburg” dhe “Adriani Company” | Nr. identifikues: 616 20 040 511 | | | | |
| Menaxheri i projektit : | Ibrahim Gërvalla | Projekti i vitit 2021 | | | | |
| Organi mbikëqyrës : | Jeton Zherka, Ramadan Nebihi | | | | | |
| Punimet e parapara dhe të realizuara me kontratë | | | | | | |
| Vëllimi fizik | Punët e parapara | -Rregullimi i rrugëve, duke përfshirë këtu kanalizimin fekal dhe atmosferik. | | | | |
| | Punët në realizim e sipër | -Punimet janë ndërprerë përkohësisht për shkak të kontesteve pronësore. | | | | |
| Vëllimi financiar | Situacionet (Pagesat e proceduara) | Situacioni 1 | Situacioni 2 | Situacioni 3 | | |
| | | 40.000.00 | | | | |



Drejtori :
Gëzim Mehmeti

Prishtinë, gusht 2021

